




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Sipas kërkesës së N.P.L."Higjiena" të dt.11.12.2020 nr.09-31232, për të ndihmuar Kompaninë Higjiena për mbështetje financiare për pagimin e borgjit që ka kompania në deponinë e mbeturinave që gjendet në qytetin e Pejës, duke u mbështetur në nenin 40.2 germa (b) dhe (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 26 pika 2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.18.12.2020, merr këtë:


V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR N.P.L."HIGJIENA" PËR TA NDIHMUAR
NË LARJEN E BORGJEVE

- I. Aprovohen mjetet financiare për ta ndihmuar Kompaninë "Higjiena" për pagimin e borgjit që ka kompania në deponinë e mbeturinave që gjendet në qytetin e Pejës, **në shumën prej 18,000.00 € (tetëmbëdhjetmijeuero).**
- II. Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga linja buxhetore e Drejtorisë për Shërbime Publike, në kategorinë Komunali. Mjetet do të derdhen në gjirrollogarinë e N.P.L. Higjiena" Deçan, në NLB Banka, nr. Gjirrollogarisë 1706020700000269, nr.biznesit 811299082.
- III. Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Deçanit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.
- V. Me vendim njoftohen: NPL "Higjiena" SH.A. Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.XIII-1

Deçan, dt.18.12.2020



Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj